



## PROCESVERBAL

Mbledhja e **Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB)** - Rahovec, e mbajtur më **09.12.2024**, me fillim në orën **15:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës **z. Smajl Latifi**. Për mbajtjen e mbledhjes kuorumi ekziston. Në fillim të mbledhjes, të pranishëm ishin 21 anëtarë.

**Kryetari:** Më lejoni t'i përshëndes anëtarët e KKSBB-së, drejtorët e drejtorive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec, z. Fazli Morina, përfaqësuesit e bashkësive fetare, të shoqërisë civile, të bizneseve, të komuniteteve pakicë, OSBE-së, LMT-së, UN-it, KLSP-së, zyrtarët komunalë dhe mediat. Sot janë edhe disa kryetarë të këshillave të lagjeve urbane dhe disa kryetarë të këshillave të fshatrave. Është mbledhja e **shtatë** e rregullt për vitin 2024 dhe me gjasë e fundit. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit,
  - Parandalimi i dhunës në familje.
  - Marrja e masave dhe vetëdijesimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike.
  - Identifikimi i vendeve ku dyshohet se të rinjtë tanë përdorin substanca narkotike.
  - Masat për parandalimin e lëmshëkërkuesve,
  - Rreth parkingjeve në qytet dhe ndriçimi publik.
3. Diskutimi për gjendjen e sigurisë në komunën e Rahovecit ne mes të anëtarëve të KKSBB-së me kryetarët e këshillave të lagjeve dhe të fshatrave të komunës së Rahovecit;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprim për KKSBB-në për vitin 2025;
5. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat;
6. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;
7. Të Ndryshme.

**Kryetari:** A ka dikush ndonjë koment për këtë rend dite? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim, kush është "për"?... A ka votë kundër?... Konstatoj që ne mund të vazhdojmë me këtë rend dite.

### 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

**Kryetari:** A ka dikush dikush ndonjë koment rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim, kush është "për"?... A ka votë kundër?...

### 2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit:

**Kryetari:** Pika e dytë e rendit të ditës i ka edhe nënpikat që po i shihni. Unë po shpresoj që ne jemi dakord që gjendja e sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit është e qetë, stabile dhe pa ndonjë ndryshim thelbësor nga mbledhja e kaluar. Vazhdojmë të kontribuojmë bashkërisht në sigurinë e përgjithshme në komunën e Rahovecit.

**Fazli Morina:** Faleminderit kryetar! I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive. Përshëndetje për anëtarët e KKSBB-së. Si zakonisht do të raportoj në pika të shkurta rreth situatës së sigurisë në territorin e

komunës së Rahovecit, me statistika si në vijim: Ne vazhdojmë me punë tona, me të gjitha dokumentet strategjike, me urdhëra operative, me plane operative dhe detyra të zakonshme. Janë implementuar dhe vazhdojnë të implementohen, 6 urdhëresa operative, 10 plane operative dhe dy planet të veprimit. Gjatë kësaj periudhe kanë ndodhur 56 vepra penale, 5 incidente jopenale. Prej këtyre, 2 raste me narkotikë, 3 raste me para falco, 3 vjedhje, 3 vjedhje të rënda, 4 armëmbajtje pa leje, 5 raste të dhunës në familje dhe 4 raste janë lëndim i lehtë trupor. Gjatë kësaj periudhe janë arrestuar 25 persona, 18 prej tyre janë mbajtur për 48 orë. Sa i përket sigurisë në komunikacion rrugor: Janë dhënë 994 gjoba në komunikacion rrugor. Prej tyre, 44 gjoba janë shqiptuar për drejtimin e automjetit pa patent shofer, 13 gjoba për mbajtje të telefonit gjatë vozitjes, 166 gjoba për parkingje joadekuate dhe 4 gjoba janë për prishje të rendit dhe qetësisë publike. Nga shkollat e komunës së Rahovecit është realizuar vetëm 1 rast, sulm në shkollë në lagjen e epërme. Gjithashtu, në shkollat e komunës së Rahovecit janë realizuar 353 patrullime dhe 35 pika kontrolli afër shkollave. Janë realizuar 6 ligjërata në 6 shkolla fillore, me temën “Parandalimi i Keqpërdorimit të Internetit” dhe 4 ligjërata në 4 shkolla fillore, me temën “Dhuna në Familje”. Në lidhje me aktivitetet për parandalimin e lëmshëkërkuesëve, stacioni policor i zhvillon aktivitetet e parapara sipas planit operativ.

**Shaip Shala:** Meqenëse është mbledhja e fundvitit, shfrytëzoj rastit t’ia uroj vitin e ri të gjithëve. E përshëndes, jo vetëm këtë raport, por të gjitha raportet e komandantit për KKSB-në. I falënderoj publikisht për mbarëvajtjen profesionale të ndeshjes së hendbollit me rumunët, e cila ka pasur jehonë në tërë Kosovën, që kinse do të jetë rrezik për siguri. Kur është fjala për dhunë në familje, unë kam propozuar që, në plan të veprimit të vitit 2025 të jetë edhe propozimi që të gjithë si KKSB të jemi inicues të mbajtjes së një tryeze, ku duhet të jenë të pranishëm të gjithë faktorët relevantë. Qëllimi i tryezës do të jetë parandalimi i dhunës në familje me plan të punës për vitin 2025, vit jubilar. I referohem kështu, sepse përpak do t’i bëj 75 vjet dhe kjo për mua është jubile, si dhe do të jem i stërkënaqur nëse si anëtar i KKSB-së, do të kontribuoj në zvogëlimin në minimum të dhunës në familje.

**Bujar Morina:** Përshëndetje kryetar! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në këtë takim. Dua të ndërlidhem me nënpikën e parandalimit të lëmshëkërkuesëve. Këtu nuk e shoh të rrezikuar komunën nga lëmshëkërkuesit. Nëse i parandalojmë, atëherë duhet t’i dalim në ndihmë, sidomos QPS-ja së bashku me Zyrën për Komunitete. Siç jemi në dijeni, 70-80% e lëmshëkërkuesëve janë nga radhët e komuniteteve Rom, Ashkali, Egjiptas dhe ndoshta 50% janë nga Republika e Shqipërisë. Unë nuk e shoh që këta e rrezikojnë sigurinë e komunës tonë.

**Enis Berisha:** Faleminderit kryetar, komandant, drejtorë të drejtorive, kolegë anëtarë të KKSB-së. Sa i përket lëmshëkërkuesëve, ne disa vite e kemi trajtuar këtë kategori në projekte të ndryshme. Besoj që është më mirë që ta kemi një strategji trevjeçare për trajtim me përkrahje nga komuna dhe nga donatorët. Të krijohet një dokument. Ta trajtojmë këtë kategori dhe kategorinë e atyre fëmijëve që punojnë punë të rënda, si dhe kategorinë e fëmijëve me sëmundje të ndryshme. Në këtë formë do ta kishim një kanal të siguruar, që këtë çështje ta kemi në kontrolle të vazhdueshëm dhe çdo herë kur ka raste të tilla, e kanë adresën e trajtimit.

**Kryetari:** Faleminderit! Sa i përket aktiviteteve kundër dhunës në familje, janë organizuar tryeza, ku kanë qenë aktivë edhe policia, prokuroria, gjykata, QKMF, QPS, shoqata e pavarur e gruas “Hareja” dhe organizatat tjera joqeveritare, që për qëllim e kanë pasur sensibilizimin, ndikimin dhe ndërgjegjësimin që dhuna në familje, dhuna në baza gjinore dhe dhuna ndaj gruas është e dënueshme. Në këtë drejtim do të vazhdojmë t’i intensifikojmë veprimet edhe në të ardhmen. Meqë jemi në fundvit, kryetari i komunës do ta lëshojë një vendim apo urdhëresë për ndalimin e mjeteve piroteknike dhe janë standardet që ne i vendosim. Tutje, policia bashkë me inspektoratin duhet ta zbusin potencialin që në këtë çështje pritet të rritet, tani në festat e fundvitit. Ju ftoj edhe juve, si anëtarë të KKSB-së të ndikoni dhe të kontribuoni që materialet piroteknike të përdoren pak dhe atë vetëm natën e ndërrimit të motmoteve. Qëllimi nuk është që ta dënojmë askënd, por, thjesht duhet

ta sensibilizojmë këtë drejtim. Sa i takon nënpikës: Identifikimi i vendeve ku dyshohet se të rinjtë tanë përdorin substanca narkotike, e respektoj komandantin në vlerësimin që e tha, por njëkohësisht insistoj që policia të jetë prezente dhe efikase në këtë dukuri, të cilat e dëmtojnë pozicionin e shoqërisë tonë. E dëgjova me vëmendje Bujarin: Lëmshëkërkuesit nuk paraqesin ndonjë rrezik për sigurinë e përgjithshme, por, besoj që edhe Bujari e din që, ata që kërkojnë lëmshë nuk e zgjidhin problemin edhe në qoftëse të gjitha paratë që i kemi në xhepa iu japim atyre. Ata paraqesin rrezik për shëndetin e tyre dhe gjithashtu edhe unë pajtohem që shteti duhet të merret më shumë me ta. Ne e kemi një rregullore që i përcakton detyrat dhe përgjegjësitë që i kemi në raport me lëmshëkërkuesit. Kjo nuk ka të bëjë me përkushtimin e Qendrës për Punë Sociale. Ka edhe prej atyre që keqpërdoren nga ndonjë “fuqi e madhe ekonomike”, gjendje kjo që nuk është mirë të diskutohet këtu dhe nuk dua të futem në detaje, sepse policia i din. Sidoqoftë, ne jemi të interesuar që mos të kemi lëmshëkërkues dhe mos ta rrezikojë askush shëndetin duhet fjetur në hapësira publike. Besoj që policia jonë ka një plan dhe natyrisht që nuk është e lehtë ta minimizojmë numrin e tyre, sepse i sheh kudo edhe në mes të Parisit ka. Të merremi vesh, nuk janë vetëm të minoriteteve, ka edhe njerëz të ngjyrave dhe kombësive të tjera. Sa i përket strategjisë që e përmendi drejtori: Strategjitë duhet të jenë shtetërore dhe nuk rregullohet kjo punë vetëm nga një komunë, sepse ky problem nuk është i izoluar dhe vetëm në një komunë. Nuk kemi as mundësi financiare, por edhe nëse kemi, është problem të trajtojmë situata të kësaj natyre. E falënderoj drejtorin për përkushtimin e tij në hartimin e asaj strategjie.

### **3. Diskutimi për gjendjen e sigurisë në komunën e Rahovecit ne mes të anëtarëve të KKSB-së, me kryetarët e këshillave të lagjeve dhe të fshatrave të komunës së Rahovecit:**

**Fazli Morina:** E falënderoj Shqipin për fjalë të mira. Është e vërtetë që ka pasur shumë festa dhe është fat i madh që të gjitha kanë kaluar pa asnjë incident dhe është festuar në mënyrë të duhur. Sa i përket identifikimit i vendeve ku dyshohet se të rinjtë tanë përdorin substanca narkotike, shumë pak kemi informata prej komunitetit. Asnjëherë nuk presim nga askush që të paktën të na sjellni një informatë rreth shitjes dhe përdorimit të narkotikëve dhe është e pamundur që të paktën ndonjë kryetari të fshatit të mos t'i ketë kaluar rreth veshit një dukuri e tillë. Ju lus për ndihmë.

**Kryetari:** Si konkluzion, natyrisht që sfida ka, por si komunë është stabile ka qëndrueshmëri nga pikëpamja e stabilitetit të sigurisë. Jemi falënderues për secilin anëtar të KKSB-së për ngritje të vetëdijes dhe për një aktivizëm qytetar që e karakterizon komunën e Rahovecit si komunë mjaft të qetë. Falënderoj gjithashtu edhe policinë tonë, me të cilën duhet të bashkëpunojmë për çdo rast që ne e shohim. Sa i përket pikës së tretë, kryetarë të fshatrave për momentin këtu janë vetëm katër. Kjo është KKSB-ja që trajton tema që lidhen me sigurinë dhe është mirë që të gjithë kryetarët e fshatrave të marrin pjesë, sepse megjithatë edhe ju jeni të zgjedhur dhe duhet ta përfaqësoni komunitetin që e keni brenda KKSB-së. Sot, nuk duhet t'ju marrë shumë kohë, sepse edhe komandanti kërkoi që të lirohet për të vazhduar tutje, sepse komandanti ka angazhime në veri. Tani, nëse keni ndonjë pyetje, ide, adresim apo plan të veprimit, ne mund ta fusim edhe në plan të punës për vitin 2025.

**Afrim Krasniqi:** Përshëndetje kryetar, drejtorë, kolegë! I nderuar komandant, edhe pse komandanti shkoi! Prej që jam në detyrë si kryetar i fshatit Pastasel, asnjëherë nuk më ka pyetur diçka policia, apo grupet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Jam pyetur nga pjesëtarët e KFOR-it, kjo i bie që janë më të interesuar sesa shërbimi ynë policor. Këtë gjë e shoh si mangësi. Nuk jemi si në vitet e 80-90-ta, ku u konsideronim si spiun, sepse sot i kemi policët tanë. Duhet që policia jonë të bëjë më shumë kontrolle në anën tonë, sepse e vërej që edhe nëpër shkolla vinë më rrallë. Mirë është këtë gjë ta përcjellni direkt te komandanti.

**Kryetari:** Po ta përcjelli direkt unë së pari. KFOR-i i ka punën e veta dhe policia punët e saj. Unë flas në cilësinë e përgjegjësive që i takoj. Policia jonë komunikon me drejtorët e shkollave dhe ti pyete drejtorin e shkollës, nëse komunikon ose jo. Ty nuk ta ndalon askush të denoncosh, nëse sheh diçka dhe mendon që është

për në polici. Nuk më pëlqej mënyra si ju qase kësaj problematike. Ju e keni detyrë të komunikoni me policinë, ashtu siç komunikoj unë. Nëse e keni ndonjë ide konkrete që KKSB-ja ta vizitojë Pastaselin, të diskutojmë për ndonjë temë, atëherë edhe policia edhe KKSB-ja do të vinë aty.

**Sejaldin Gashi:** Përshëndetje për të gjithë! Ne po flasim për një gjeneratë të re, e cila nuk i ka kushtet të shkojë në lokale. Po flasim për një gjeneratë që mund të bëjë grupime të vogla. Kam kërkuar që, në bazë të mundësive të ndërtojmë qendra rinore, ku mund të takohen shoqëritë edhe me shpenzime të vogla. Ndoshta më të lehtë do t'i kishim nën kontrollë fëmijët tanë.

**Kryetari:** Shumë fëmijë janë të përfshirë në qendrën SHL – Kosova, në disa lloje të aktiviteteve që organizohen. E vërtetë është që mirë do të ishte që në çdo lokalitet të ketë qendra rinore, po ashtu e vërtetë është që duhet investime kolosale, të cilat nuk janë të mundshme të bëhen nga Komuna e Rahovecit dhe nga asnjë komunë e Republikës së Kosovës, përfshirë edhe kryeqytetin. E kemi qendrën rinore në Rahovec, e cila ka mundësi të adaptimit për nevoja të rinisë. Një qendër tjetër kulturore dhe multifunksionale po ndërtohet këtu përballë. Faleminderit Selajdin. Si konkluzë e kësaj pike del të jetë që, është e domosdoshme që KKSB-ja të zbarkojë në terren dhe ta bëjë ndonjë aktivitet që t'i identifikojë nevojat specifike, në Pastasel, Çifllak, Sopniq dhe në të gjitha fshatrat dhe komunitetet tjera, për t'i diskutuar temat që lidhen me siguri.

#### **4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprim për KKSB-në për vitin 2025:**

**Kryetari:** Ju e keni një projekt-plan afër vetes. Nëse ju jeni dakort, unë kërkoj që një kërkesë ta fusim në plan të veprimit, që ta zgjerojmë më shumë KKSB-në, duke vepruar edhe në terren dhe jo vetëm në këtë sallë. A keni edhe ndonjë ide tjetër?... Nëse jo, atëherë edhe një javë keni kohë nëse ju kujtohet ndonjë ide. Në e fusim në votim dhe e votojmë parimisht. Ky plan futet në votim edhe në asamble komunale.

**Mustafë Korenica:** Së pari i përshëndes të gjithë të pranishmit në sallë. Skender, nuk e kam pranuar këtë plan në e-mail! Nëse është në dijeni Skenderi të më tregojë kur e ka dërguar dhe në çfarë forme?

**Kryetari:** A ka edhe dikush tjetër që nuk i ka shkruar emaili? Sidoqoftë, sekretaria do të kujdeset për këtë gjë. Pra, si konkluzë e kësaj pike, mbetet që t'i shprehni idetë për aktivitete, propozime, vizita, tryeza e shumë ide tjera. Vizitat mund të realizohen kudo.

**Skender Hamza:** Mustafë, emaili te unë është në "sent"! Ta kam dërguar te info\_korenica-ks.com. Ndoshta është problemi te emaili juaj. Unë do ta dërgoj përsëri.

**Kryetari:** Atëherë, projekt-planin e punës së KKSB-së 2025, duke i përfshirë edhe këto dy ide të përmendura, të Afrimit e Selajdit, në parim e vendosim në votim. Kush është "për"? A ka votë kundër?... Me shumicë votash u votua draft-plani.

#### **5. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat:**

**Përparim Krasniqi:** Faleminderit kryetar! Përshëndetje për të gjithë anëtarët e KKSB-së, monitoruesit, kryetarët e fshatrave, të pranishmit. Në rrugën rrugën "Xhelal Hajda" kohët e fundit e keni parë një ujë që rrjedhë në rrugën kryesore. Kjo është falë personave të papërgjegjshëm që kanë hedhur mbeturina në kanalizimin e ujërave fekale. Ky kanal i ujërave të zeza është i ndërtuar në vitin 2002, diametrin e ka f-600 dhe përballon ujëra të zeza për 20.000 banorë. Tani ka ardhur në një gjendje jo të mirë, për shkak të eshtrave që janë hedhur në atë kanalizim dhe mezi kemi arritur që ta deblllojmë. Përveç kësaj, sot nga kanalizimi në atë rrugë kemi nxjerrë edhe mbeturina, rroba e leckat të ndryshme. Përmes KKSB-së duhet të bëjmë thirrje që ta ruajmë mjedisin kudo që jemi. Situata me lumenj qëndron mirë. Ne kemi filluar trajtimin e lumenjve në shumë vendbanime dhe kur ka reshje nuk ka vërshime të lumenjve.

**Sejaldin Gashi:** Në Çifllak është një deponi e mbeturinave të ngurta, mirëpo nuk kontrollohet ajo, mbushet shumë shpejt dhe nuk ka vend për mbeturina tjera. Propozoj që dikujt t'ia jepni në menaxhim, që operatori ta pastrojë vendin në momentin që mbushet me mbeturina.

**Kryetari:** Ne kemi vetëm një deponi legale të licencuar përmes ekspertizës së Demos-it nga Ministria e Planifikimit Hapësinor. Deponia e mbetjeve të ngurta e inerte është në rrugën Rahovec-Drenoc, në krahun e majtë, të gjitha të tjerat janë ilegale. Kjo deponi është në menaxhim. Te deponitë tjera që janë ilegale, ne jemi duke i pastruar dhe po harxhojmë edhe buxhet. Kërkojmë që nëse dikush ka mbeturina inerte, mirë është ta lajmërojë inspektoratin dhe ata ia tregojnë vendin. Përndryshe, nëse hedhen vend e pa vend, përveç që nuk është imazh i mirë, dënimi është i pashmangshëm, sepse jemi një ndër komunat më të pastërta në Republikën e Kosovës.

##### 5. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore:

**Kryetari:** Inspektor sanitar nuk kemi, sepse është i centralizuar. Drejtoresha do të flet, sepse këta kanë bashkëpunim edhe me inspektoratin qëndror.

**Norë Boshnjaku:** Faleminderit kryetar! Përshëndetje për komandantin, anëtarët e KKS-së, kryetarë të fshatrave dhe të pranishmit. Në vazhdimësi kemi pasur inspektime bashkë me inspektorët e tregut dhe ata sanitarë. Kohëve të fundit, inspektimet janë kryer edhe në objektet ju përpunohen ushqimet, në magazina, në markete dhe në supermarkete, në qytet dhe në fshatra. Gjatë inspektimeve janë marrë disa masa administrative ndaj të gjitha subjekteve juridike që veprojnë në territorin e komunës së Rahovecit, si gjoba mandatore, fletëparaqitje në gjykatë, gjoba administrative, njoftime verbale, vërejtje verbale dhe të gjitha masat e tjera ligjore. Gjatë kësaj periudhe janë shqiptuar 34 gjoba mandatore. Nga inspektorët e tregut janë shqiptuar gjoba për verifikim të origjinës së mallit, për mospërputhje të çmimit në raft dhe në arkë dhe nga inspektorët sanitarë janë ndërmarrë masa si: Testim të produkteve ushqimore, marrja e mostrave në analiza laboratorike. Planifikojmë që edhe këtë muaj t'i inspektojmë marketet dhe supermarketeve, meqë festat janë afër dhe do të kemi një numër të madh të mërgimtarëve.

**Afrim Krasniqi:** E kam një kërkesë në lidhje me kapakët e pusetave. Në Pastasel, 4-5 janë të demoluara dhe të thyera. Nëse keni mundësi ta bëni një intervenim.

**Kryetari:** Faleminderit Afrim! Besoj që po, sepse e kemi një kontratë në lidhje me pusetat.

##### 7. Të Ndryshme:

**Kryetari:** Nëse dikush ka diçka për të shtuar?... Nëse jo atëherë, meqë jemi në prag të festave të fundvitit, urime për ata që i festojnë Krishtlindjet. Urime për festën e ndërrimin të motmoteve. Deri në fillim të vitit të ri, do të kemi mundësi të shihemi në formate tjera. Bashkë me policinë do të kujdesemi ta përballojmë edhe fluksin e madh të njerëzve që do të vinë. Ju falënderoj të gjithëve për kontributin.

Procesmbajtësi

Albion Krasniqi

Kryetari i Komunës

Smajl Latifi



